

VENDIM
Nr. 96, datë 9.5.2022

**MBI RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 29, DATË 14.2.2022,
“MBI NDRYSHIMIN E PJESSHËM TË PËRKOHSHËM TË VENDIMIT TË BORDIT
TË ERE-s NR. 146, DATË 10.9.2020, ‘MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘SEKA
HYDROPOWER’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC ‘SEKË’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 12667 kw, DHE
‘ZAIS’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2295 kw, ME KAPACITET TOTAL TË
INSTALUAR 14962 kw”**

Në mbështetje të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 68, pika 1, gërma “b” dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 16 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 3.9.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.5.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 579/4 prot., datë 22.4.2022 dhe relacionin shtesë nr. 579/4-1 prot., datë 5.5.2022, të Drejtorive Teknike, Në vijim të relacionit nr. 579/4 prot., datë 22.4.2022, “Mbi rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 39, datë 10.3.2022, ‘Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Seka Hydropower’ sh.p.k. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 29, datë 14.2.2022, ‘Mbi ndryshimin e pjesshëm të përkohshëm të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Seka Hydropower’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Sekë’, me kapacitet të instaluar 12667 kw dhe ‘Zais’, me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total të instaluar 14962 kw””,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 39, datë 10.3.2022, ka vendosur:

“1. Të pranojë shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 29, datë 14.2.2022, “Mbi ndryshimin e pjesshëm të përkohshëm të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Seka Hydropower’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Sekë’, me kapacitet të instaluar 12667 kw dhe ‘Zais’, me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total të instaluar 14962 kw””.

2. Shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k., në cilësinë e palës së interesuar, brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga marrja dijeni e këtij vendimi, të depozitojë në ERE aktin përkatës të ekspertimit ose çdo dokument tjetër të hartuar nga persona të licencuar të fushës, ku të vërtetohet se bazuar në përcaktimet e VKM-së nr. 59, datë 26.1.2022, HEC “Zais” ndodhet jashtë zonave të mbrojtura.

3. ERE do të shqyrtojë dokumentacionin e depozituar nga shoqëria sipas përcaktimeve të pikës 2, të këtij vendimi, brenda 10 ditëve pas paraqitjes së këtij dokumentacioni.

4. Pezullimin e zbatimit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 29, datë 14.2.2022, “Mbi ndryshimin e pjesshëm të përkohshëm të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Seka Hydropower’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Sekë’, me kapacitet të instaluar 12667 kw, dhe ‘Zais’, me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total të instaluar 14962 kw””, sipas vendimit datë 25.2.2022, të Gjykatës së Lartë.”.

- ERE, me shkresën nr. 332/2 prot., datë 23.3.2022, njoftoi shoqërinë “Seka Hydropower” sh.p.k., av. Dorina Ndreka, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, OST sh.a. dhe FSHU sh.a. për vendimin si më sipër.

- Në vijim të këtij njoftimi dhe brenda afatit të përcaktuar në pikën 2, të vendimit sipërcituar, shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacionin përkatës në plotësim të kushtit 2, të vendimit të

Bordit të ERE-s nr. 39/2022, ku konfirmohet se HEC “Seka” dhe “Zais” ndodhen jashtë zonave të mbrojtura mjedisore.

Në rrethanat kur vetë shoqëria, nëpërmjet dokumentacionit të nënshkruar nga ekspertë të fushës ka vërtetuar se HEC “Seka” dhe “Zais” ndodhen jashtë zonës së mbrojtur, referuar VKM-së nr. 59, datë 26.1.2022, e po ashtu Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 19, datë 25.2.2022, ka vendosur pranimin e kërkesës (së paraqitur nga Avokatura e Shtetit, ERE dhe vetë pala e interesuar) për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 559 (86-2021-671), datë 10.11.2021, të Gjykatës së Apelit, vlerësohet pranimi i kërkesës së shoqërisë për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 29/2022, duke e shfuqizuar atë për arsye se ka rënë shkak për të cilin u mor ky vendim, çka e kthen subjektin në gjendjen e mëparshme, sikurse licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020.

- Në çdo rast, në varësi të vendimarrjes së Gjykatës së Lartë në lidhje me rekursin e depozituar nga ERE, apo në rast të daljes së ndonjë akti nga organet kompetente që mund të ndryshojë rrethanat e kësaj vendimarrjeje, ERE rezervon të drejtën që në vijim të shprehet në përputhje dhe në zbatim të këtyre akteve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 29, datë 14.2.2022, “Mbi ndryshimin e pjesshëm të përkohshëm të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Seka Hydropower’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Sekë’, me kapacitet të instaluar 12667 kw, dhe ‘Zais’, me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total të instaluar 14962 kw”.

2. Të shfuqizojë vendimin e Bordit të ERE-s nr. 29, datë 14.2.2022, “Mbi ndryshimin e pjesshëm të përkohshëm të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Seka Hydropower’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Sekë’, me kapacitet të instaluar 12667 kw, dhe ‘Zais’, me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total të instaluar 14962 kw”.

3. Ky vendim është objekt rishikimi në varësi të vendimarrjes së Gjykatës së Lartë për rekursin e paraqitur nga ERE apo çdo akti tjetër të dalë nga organet kompetente që mund të ndryshojë rrethanat e kësaj vendimarrjeje.

4. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë av. Dorina Ndreka, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, OST sh.a. dhe FSHU sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti